



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
BASHKIA KUÇOVË

Nr. prot 607

Kuçovë, më 06/02/2026

Vendim

Nr. 8 . Datë 28/01/2026

“Mbi miratimin e planit të punës të Këshillit të Bashkisë Kuçovë dhe planit të vendimarrjes për periudhën Janar-Dhjetor 2026 dhe planit vjetor të konsultimeve ”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e Dt / / 2026 ,pasi shqyrtoi materialin e paraqitur për miratim nga grupi i punës “Mbi miratimin e planit të punës të Këshillit të Bashkisë Kuçovë dhe planit të Vendimarrjes për periudhën Janar-Dhjetor 2024”, mbështetur me ligjin nr.139/2015 dt.17.12.2015”Për Vetqeverisjen Vendore”,ligji nr . 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 16 ,

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të punës të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar –Dhjetor 2026.
2. Miratimin e planit të vendimarrjes të Këshillit Bashkiak për periudhën Janar – Dhjetor 202.6.
3. Miratimin e planit vjetor të Konsultimeve

Janar

Raport Vjetor për zbatimin e rezolutes kundër dhunes ndaj grave.

Plani dy vjecar i trajnimit të Këshillit bashkiak

Hartimi i indikatorëve të Performances për menaxhimin e mbetjeve.

Shkurt

Informacion: Mbi zbatimin e buxhetit si edhe realizimi i të ardhurave për Bashkinë Kuçovë për vitin 2025.

Informacion: Analiza vjetore mbi punën e Këshillit Bashkiak .

Informacion:Raporti i Monitorimit Janar-Dhjetor 2025..

Informacion:Ne lidhje me aktiveve të Bashkisë.

Mars

Informacion: Mbi punën e bërë nga Agjensia E Shërbimeve Komunale për mbjelljen e fidanëve të rinj për shtimin e gjelbërimit , si dhe masat e marra për riparimet e rrugëve në të gjithë territorin e bashkisë Kuçovë .

Hartimi i raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes së Këshillit

Sondazh mbi prioritetet e komunitetit

Vizite studimore ne Kosove te Kryesise se Keshillit bashkiak

Prill

Informacion: Për zbatimin e buxhetit dhe realizimit e të ardhurave për Bashkinë Kuçovë për 3 mujorin e parë të vitit 2026.

Informacion: Mbi inventarin e pasurive të patundshme të Bashkisë Kuçovë.

Maj

Informacion: Mbi gjendjen dhe masat e marra për kanalet vaditës në njesitë administrative të Bashkisë Kuçovë.

Raport mbi zbatueshmerine e projekteve dhe objektive te Planit te pergjishem vendor dhe dokumentave strategjike

Qershor

Informacion: Nga stacioni për mbrojtjen kundër zjarrit (M.Z.SH) , për mbulimin dhe përballimin e situatave për ruajtjen nga zjarri dhe emergjencave civile.

Informacion: Mbi vlerësimin e punës së sipërmarrjeve private për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit, si shërbimi i pastrimit, dekorit ,mrëmbajtja e varrezave etj .

Informacion : Mbi punën e bërë nga Komisariati i Policë ,për parandalimin e goditjeve të akteve kriminale ,për garantimin e qetësisë dhe rendit në Kuçovë.

Korrik

Informacion: Mbi furnizimin me ujë të pijshëm, cilësinë dhe masat e marra ndaj abuzuesve të ujit të pijshëm në bashkinë Kuçovë.

Trajnim per tematika (Rruget rurale dhe sherbimet publike) me fond te K.B

Gusht

Diskutime per Njesite e Performances dhe Zyra te zhvillimit Ekonomik Lokal

Informacion: Mbi masat e marra nga Agjensia e Ndërmarrjes Komunale, për mirëmbajtjen e institucioneve arsimore për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026.

Shtator

Informacion : Analiza e zbatimit të buxhetit për 8 mujorin e vitit 2026 për periudhën Janar-Gusht 2026 (Drejtoria e Financës-Drejtoria e të Ardhurave)

Informacion : Mbi cilësinë e pastrimit në Bashkinë Kuçovë . (sondazh per kenqagesine e qytetareve)

Informacion: Mbi fillimin dhe objektivat e ekipit të futbollit “NAFTËTARI” për sezonin futbollistik 2025-2026..

Tetor

Informacion: Informacion nga Zyra e Punës mbi punësimet e bëra për profile pune të ndryshme dhe mbi bazën e specialiteteve /kualifikimeve që punë kërkesit kanë në ndërmarrjet shtetërore dhe private ,e dokumentuar sipas regjistrit të punësimeve.

Informacion: Si dhe sa janë realizuar projektet dhe investimet nga Bashkia Kuçovë. Monitorimi i realizimit të 9-mujorit të ardhurave

Nëntor

Projekt-Vendim :Mbi miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2025 .

Informacion : Mbi masat e marra për garantimin e bazës materiale të nevojshme ,për përballimin e problematikave që ka stina e dimrit .

Dhjetor

Projekt –Vendim: Mbi miratimin e Buxhetit për vitin 2026.

Projekt-Vendim : Mbi shqyrtimin e kërkesave të nxënësve për marrjen e bursave për vitin arsimor 2025-2026.

Ky vendim u miratua me _____ vota pro, _____ vota kunder, _____ vota abstenim në prezencë të _____ këshilltarëve.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Aleksandër ZIU

